

NJOFTIM PËR MEDIA

SEANCA PLENARE DATË 03 KORRIK 2023

Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi ditën e hënë, më 03 korrik 2023, mbledhjen plenare të radhës në prani të 9 (nëntë) anëtarëve të Këshillit, si dhe në prani të përfaqësuesve të misionit OPDAT dhe medias. Mbledhja u drejtua nga Zëvendëskryetari zoti Tartar Bazaj. Nuk ishin të pranishëm Kryetari z.Alfred Balla i cili kishte ditën e raportimit në Parlament dhe z.Zeqir Hoda për një angazhim familjar.

Në mbledhje u miratuan:

- U zhvillua seanca dëgjimore e palëve (ILD dhe Magjistrati), për procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit S.H. Shpallja e vendimit do të bëhet në datë 17.07.2023 ora 10.00.
-
- Vendimet “Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Durrës**, për pozicionin e shpallur vakant **Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.5** dhe **Nr.6** me vendimin Nr.92, datë 09.05.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procedurës së lëvizjes paralele”, respektivisht u caktuan prokurorët: **Elidon Hysenaj; Riselda Fishta, Suela Beluli, Alma Bramo, Ilir Hoxha dhe Anton Pali;**
- Vendimi “Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Elbasan**, për pozicionin e shpallur, me vendimin Nr.92, datë 09.05.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procedurës së lëvizjes paralele” Këshilli caktoj prokuroren **Ermira Manelli;**
- Vendimet “Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Shkodër**, për pozicionin e shpallur vakant **Nr.1** dhe **Nr.2**, me vendimin Nr.92, datë 09.05. 2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procedurës së lëvizjes paralele”, u caktuan respektivisht prokurorët **Adnan Hoxha dhe Ledion Tema.**
- Vendimet “Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Tiranë**, për pozicionin e shpallur vakant **Nr.1, Nr.2** dhe **Nr.3**, me vendimin Nr.92, datë 09.05.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procedurës së lëvizjes paralele” respektivisht u caktuan prokurorët **Eranda Felaj, Asllani Barjamaj dhe Julian Çafka;**
- Vendimet “Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Vlorë**, për pozicionin e shpallur vakant **Nr.1** dhe **Nr.2**, me vendimin Nr.92, datë 09.05.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas

procedurës së lëvizjes paralele”, respektivisht u caktuan prokurorët **Aurora Hajro dhe Alba Dhima**;

- Vendimet për përfundimin pa vendim përfundimtar, të procedurës së lëvizjes paralele, shpallur me Vendimin Nr.92, datë 09.05.2023 të KLP-së, për pozicionin **vakant Nr.1**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Lezhë**”, si dhe për pozicionet **vakant Nr.1 dhe Nr.3** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Fier**”, për shkak se në vijim të procedurës së transferimit nuk mbeti asnjë kandidat në garë.
- Vendimet për transferimin e përkohshëm me pëlqim të prokurorit **Xhevahir Lita** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Kukës**”, dhe caktimin e përkohshëm të tij në pozicionin e drejtuesit të kësaj Prokurorie.
- Vendimet për transferimin e përkohshëm me pëlqim të prokurorit Petrit Çano në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm **Gjirokastër**”, dhe caktimin e përkohshëm të tij në pozicionin e drejtuesit të kësaj Prokurorie.
- Në përfundim, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës u miratua projektakti “Për shpalljen e **26** (njëzet e gjashtë) pozicioneve të lira në Prokuroritë pranë Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe konkretisht: Berat (**3**), Dibër (**1**), Durrës (**1**), Elbasan (**1**), Fier (**5**), Gjirokastër (**3**), Korçë (**3**), Lezhë (**2**), Vlorë (**4**), Sarandë (**3**), për magjistratët e emëruar nga Shkolla e Magjistraturës për vitin 2023”.

U la si afat data 10 korrik 2023, dita e fundit kur, kandidatët mund të ndajnë me vullnetin e tyre këto vende sipas klasifikimit të arritur në Shkollë. Nëse nuk do të ketë dakordësi mes tyre, i takon Këshillit të ndaj pozicionet duke i caktuar në detyrë në seancën e datës 10 korrik 2023.

Në datën **12 korrik ora 10.00 do të zhvillohet në KLP, betimi i 26 magjistratëve të rinj**, ku do marrin pjesë përveç Këshillit dhe prokurorëve edhe të ftuar, familjarë, e drejtues. **Media është e ftuar në këtë ditë festive të marrë pjesë.**